

Sot ose nesër pritet të vendoset nëse blloku VLAN do të vazhdoj siç ishte tani e pesë muaj apo LDK do t'i marr AAK-së, postin e kryeministrit me rishikimin e marrëveshjes së 10 qeshorit. Ndërsa, si opsion i fundit flitet edhe ndarja e koalicionit paszgjedhor.

Megjithatë, përfaqësues të subjekteve që janë pjesë e Bllokut, kanë paralajmëruar se sot ose nesër do të jenë ditët vendimtare sa i përket të ardhmes së bllokut.

Kështu të paktën kanë thënë përfaqësuesit e Bllokut, pas takimit që patën të premtën në orët e vona, ku Ramush Haradinaj tha se përderisa nuk ka marrëveshje tjetër, ajo e 10 qershorit mbetet në fuqi, madje sipas tij, do të mundohen ta ruajnë këtë shumicë, jo për inati të askujt por për të ecur përpara.

Kurse, të shtunën e të dielën që lamë pas, si përfaqësuesit e AAK-së, ashtu edhe ata LDK-së, janë shprehur se duan postin e kryeministrit, madje kanë filluar edhe ta akuzojnë njëri tjetrin për dështime.

Në anën tjetër, vizita e ministrit të Punëve të Jashtme të Gjermanisë për shtetet e Evropës Juglindore, Ernst Reichel, i cili është duke qëndruar në Kosovë, në përpjekje për të ndihmuar liderët partiakë për të gjetur një zgjidhje, si dhe deklaratat e ambasadores amerikane Tracy Ann Jacobson, e po ashtu të atij britanik Ian Cliff, që sa më parë të thirret seanca, janë shenjat e ndërhyrjes ndërkombëtare.

Ndryshe, ndërkombëtarët pritet të jenë aktiv edhe këtë javë kur pritet që vendi të dal nga kriza politike që ka ardhur pas zgjedhjeve të fundit.